Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/505
Datë: 05.08.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.08.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "TC MEISTER", me adresë: Magjistralja Prishtinë - Ferizaj Km4, Llapnasellë, Graçanicë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 05.08.2022 deri më 04.08.2025, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
   - 1.1 **Instalues Elektrik**, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 62 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga dhjet (10) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tetë (8) grup.
   - 1.2 **Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjellësit,** Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 46 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga dhjet (10) kandidat në një grup dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tetë (8) grup.
   - 1.3 **Operator i Robotëve Industrial-Teknik i Drejtimit të Proceseve Mekatronike**, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 65 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzetekatër (24) kandidat dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në pesë (5) grupe.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit "TC MEISTER", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "TC MEISTER", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK